REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 19 Datë 10. 04. 2017

"MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE" SUBJEKTIT "RENEWABLE-ENERGY" SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe proçedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni", për paisjen me autorizim të subjektit **"RENEWABLE-ENERGY",** me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit **"RENEWABLE-ENERGY" SH.P.K.,** me administrator Z.Artan ÇIRRAGA, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Dushit dhe Lugu i Menes,** degë të Përroit të Shullerit, degë e Lumit Zalli i Bulqizës, degë e Lumit Drin i Zi , për prodhim energjie elektrike, në fshatin Dushaj, Njësia Administrative Fushë-Bulqizë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC DUSHK do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës marrjes1	X_1 – 44 41 868;	Y_1 – 46 00 270;	Z_1 – +820m
Koordinatat e veprës marrjes2	X_2– 44 42 010;	Y_2 – 46 00 160;	Z_2 – +820m
Koordinatat e godinës së centralit:	X – 44 42 300;	Y – 45 97 900;	Z - +610m;
Koordinatat e pikës së shkarkimit:	X – 44 42 300;	Y – 45 97 900;	Z - +610m;

Prurja mesatare vjetore e burimit : Q_1 mes= 0.365 m³/sek; Q_2 mes= 0.104 m³/sek;
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q_1llog = 0.43 m³/sek; Q_2llog = 0.122 m³/sek;
Prurja ekologjike: Q_1ekol= 0.072m³/sek; Q_2ekol= 0.02m³/sek;
Prurja që shkarkohet: Q= 0.552m³/sek.

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR
Martin PLLUMBI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT - KËSHILLI I BASENIT DRIN-BUNË

KRYETAR
Paulin RADOVANI